



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 179, datë 27.11.2025

PËR

**MIRATIMIN E ZGJERIMIT TË VEPRIMTARISË TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT
“ATLANTIK-SHOQËRI SIGURIMESH” SH.A. DHE NDRYSHIMIT TË STATUTIT TË
SHOQËRISË**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, nenit 36 dhe 57, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, si dhe Rregullores nr. 138, datë 21.12.2015 “Për miratimin ose refuzimin e ndryshimeve thelbësore të statutit të shoqërisë së sigurimit”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e zgjerimit të licencës së shoqërisë “Atlantik-Shoqëri Sigurimesh” sh.a., me klasën 4 - sigurimi i mjeteve lëvizëse mbi shina mbulon dëmtimet ose humbjet nga mjetet lëvizëse mbi shina; klasën 12 - sigurimi i përgjegjësive për anijet (detare, të liqeneve dhe të lumenjve, si dhe ato të kanaleve) mbulon të gjitha përgjegjësitë që lindin nga përdorimi i anijeve ose barkave (anije të vogla), që lundrojnë në det, liqene, lumenj dhe kanale lundrimi (përfshirë përgjegjësitë e transportuesit); klasën 18 - sigurimi i asistencës (ndihmës).
2. Miratimi i ndryshimit të nenit 7, të statutit të shoqërisë “Atlantik-Shoqëri Sigurimesh” sh.a., si rezultat i zgjerimit të veprimtarisë, me përmbajtje si vijon:

“Shoqëria “Atlantik-Shoqëri Sigurimesh” sh.a. ka për objekt të saj ushtrimin e veprimtarisë në fushën e sigurimeve në përputhje me ligjin nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, në përputhje me lejen e datës 01.06.2001 të Komisionit të Mbikëqyrjes së Sigurimeve për fillimin e ushtrimit të aktivitetit të sigurimeve dhe/ose risigurimeve si dhe vendimit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për miratimin e kërkesës për zgjerimin e veprimtarisë në klasën 4, 12, 18.”

3. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit, për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Saimir TOLA

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Mimoza KAÇI